



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 5337 /2018

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 12, 40, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 16.07.2018 merr:

V E N D I M

PËR THEMELIMIN E GRUPIT PUNUES PËR HARTIMIN E PLANIT TË PUNËS SË KUVENDIT

I

Kuvendi i komunës miratoi vendimin për themelimin e grupit punues për hartimin e planit të punës së kuvendit të komunës për vitin 2019.

II

Grupit punues për hartimin e planit të punës së kuvendit përbehet prej 7 (shtatë) anëtarëve dhe i njëjti do të ketë këtë përbërje:

1. Qamush Brava - AAK
2. Nora Xhoni - AAK
3. Akif Shkreta - VV
4. Samire Curri - LDK
5. Mehmet Ballazhi - PDK
6. Mefail Suma - NISMA
7. Shabi Rexhallari -Drejtor i Financave

III

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës –MAPL, si dhe pas publikimit në webfaqen zyrtare të komunës.

IV

Me këtë vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Anëtarët e grupit punues, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data: 16.07.2018





01/Nr. 5744 /2018

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 40, Udhëzimin Administrativ Nr.10/2010 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativë Nr.41/2006 të datës 27.12.2006 për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore neni 6, pika 6.3, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 16.07.2018 merr:

V E N D I M
PËR NDËRRIM DESTINIM TË TOKËS BUJQËSORE

I

Kuvendi i komunës miratoj vendimin për ndërrim destinim të përhershëm të tokës bujqësore në atë ndërtimore për pronarin z.Minir Curri sipas kërkesës së tij.

II

Sipërfaqja e lejuar bujqësore për ndërrim të destinimit është 300 m², në vendin e quajtur "Kodra Vakof" zona kadastrale Neqafc, më kulturë arë e klasit të gjashtë (6), e evidentuar në emër të z.Minir Curri, sipas certifikatës pronësore P-73317063-00350-1.

III

Pronari i palujtshmërisë në emër dhe interes të të cilit bëhet ndërrim destinimi nga toka bujqësore në tokë ndërtimore obligohet që pronën ta shfrytëzoj vetëm për qëllimin e caktuar (ndërtimi i shtëpisë për banim) e nuk mund të përdoret për qëllime të tjera.

IV

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesën: Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural në bazë të ligjeve në fuqi.

V

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës – MAPL-së dhe pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

VI

Më këtë Vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Pala, Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, dhe Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit

Data: 16.07.2018

Kryesuesi i Kuvendit
Qamush Brava





01/Nr.5458 /2018

Në bazë të nenit 12, nenit 17 shkronja (b), neni 40 shkronja (l) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr. 03/L-040, ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr.28/2008 dt. 04 qershor 2008), nenit 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 nën paragrafi 1.2.1, nenit 10 paragrafi 2 nën paragrafi 2.1 dhe nenet 11, neni 15 dhe neni 26 i Ligjit për Planifikimin Hapësinor Nr. 04/L- 174, ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr.30/2013 dt. 23.08.2013), si dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 11/2015 Mbi elementet dhe kërkesat themelore për Hartimin, Zbatimin dhe Monitorimin e Planit Zhvillimor Komunal, nenit 32 të Statutit të Komunës së Hanit të Elezit, 01 Nr. 2487 datë 24.12.2014, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit, në mbledhjen e mbajtur me datë 16.07.2018 merr:

VENDIM

PËR FILLIMIN E HARTIMIT TË PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL

I

Lloji i dokumentit të planifikimit hapësinor

Kuvendi i komunës miratoi vendimin për fillimin e procesit të hartimit të Planit Zhvillimor Komunal të Hanit të Elezit, "në tekstin e mëtejme: PZHK".

II

Përkufizimi i dokumentit të planifikimit hapësinor

Me këtë vendim përkufizohet dokumenti i planifikimit hapësinor, Plani Zhvillimor Komunal (PZHK) në harmoni me ligjin si: Plan strategjik multi-sektorial i cili përcakton caqet afatgjata të zhvillimit ekonomik, social dhe hapësinor. PZHK duhet të përfshijë planin për zhvillimin e zonave urbane dhe rurale për periudhën tetë (8) vjeçare.

III

Qëllimi i hartimit

Me PZHK nga neni 1. i këtij vendimi, planifikohet zhvillimi hapësinor në kontekst të ndryshimeve të bëra dhe harmonizimit të tyre me nevojat reale dhe mundësitë për të arritur kushte optimale të zhvillimit dhe organizimit hapësinor të Komunës së Hanit të Elezit duke u bazuar në profilin dhe vlerësimin e gjendjes përcaktohet korniza e zhvillimit hapësinor të sajë respektivisht vizioni, parimet, qëllimet, objektivat dhe koncepti i zhvillimit hapësinor, si dhe prioritetet e zhvillimit strategjik dhe plani i veprimit. Me PZHK plotësohen kërkesat ligjore për të përgatitur Plan strategjik multi-sektorial, i cili përfshin planifikimin dhe zhvillimin e zonës urbane dhe rurale.

IV

Kufiri i territorit

Sipas Ligjit Nr. 03/L-041 PërKufijtë Administrativ të Komunave, Shtojca I ku (sipas këtij ligji Komuna e Hani Elezit ka 11 Zona Kadastrale). Zonat Kadastrale në territorin e Komunës të përfshira janë:

Zona Kadastrale	Kodi i Z.K.	Sipërfaqja m ²	Sipërfaqja ha
Hani i Elezit	73317036	1162277	116.2277
Dimcë	73317025	2120222	212.0222
Dërmjak	73317034	6152071	615.2071
Gorancë	73317019	20801160	2080.116
Krivenik	73317055	12279970	1227.997
Neçavac	73317063	4377620	437.762
Paldenicë	73317066	4046055	404.6055
Pustenik	73317070	10872900	1087.29
Rezhancë	73317073	8508690	850.869
Seçishtë	73317079	8449990	844.999
Vërtomicë	73317015	4386103	438.6103
GJITHSEJ SIPEFAQET:			8315.7058 ha

V

Subjekti përgjegjës për hartim

Bartës i hartimit të PZHK-së caktohet Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit të Komunës së Hanit të Elezit (DUKMM).

VI

Mjetet dhe mekanizmat e nevojshëm për hartim

Mjetet për hartimin e PZHK-së dokumentit të planifikimit hapësinor sigurohen nga buxheti i Komunës së Hanit të Elezit. Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit koordinon procesin e hartimit dhe miratimit të PZHK-së në bashkëpunim me drejtoritë sektoriale dhe burimet njerëzore përbrenda Komunës. Për shkak të mungesës së kapaciteteve njerëzore, përmes kontratës mbi vepër, Komuna e Hanit të Elezit, do të angazhojë bashkëpunëtor profesional për të mbështetur procesin e hartimit të PZHK- së.

VII

Afati i hartimit

Bartësi i hartimit të PZHK-së (sipas nenit 5 të këtij vendimi), procesin e hartimit dhe miratimit të HZK-së do ta përfundojë në afat prej 13 muaj nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

VIII

Konsultime Publike

Propozim- PZHK para finalizimit duhet të vihet në konsultime publike dhe në shqyrtim publik. Paraqitja e Propozim-PZHK-s në shqyrtim publik dhe koha për dhënien e shqyrtimeve dhe komenteve do të shpallen përmes njoftimeve publike.

IX

Afati i Vlefshmërisë

Dokumenti i planifikimit hapësinor, PZHK hartohet për periudhën kohore 8 (tetë) vjeçare.

X

Gjuha zyrtare

Dokumenti i planifikimit hapësinor sipas nenit 1 të këtij vendimi duhet të jetë në gjuhët zyrtare të Komunës dhe së paku në 3 (kopje) të shtypura e të vulosura dhe 3 kopje digjitale të origjinalit.

XI

Programi

Pjesë e këtij vendimi është programi për hartimin dhe menaxhimin e procesit të planifikimit i paraparë me nenin 11, paragrafi 1.3. të Ligjit për Planifikimin Hapësinor Nr. 04/L-174. Procesi i hartimit të PZHK-së do të zhvillohet sipas programit ku janë përcaktuar fillimi, përfundimi dhe kohëzgjatja e parashikuar e secilës fazë dhe për secilën fazë janë përcaktuar aktivitetet, produktet dhe rezultatet e pritura.

XII

Hyrja ne fuqi

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës – MAPL-së dhe pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

XIII

Me këtë vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtorja për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, dhe Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data: 16.07.2018





01/Nr. 6024 /2018

Në bazë të nenit 12, nenit 17 shkronja (b), neni 40 shkronja(l) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr. 03/L-040, ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr.28/2008 dt. 04 qershor 2008), nenit 5 paragrafi 1.2 nën paragrafi 1.2.2, nenit 16 dhe nenit 26 të Ligjit për Planifikimin Hapësinor Nr. 04/L-174, datës gazeta zyrtare 30/23 gusht 2013, si dhe Udhëzimit Administrativ Nr.24/2015 mbi elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Hartës Zonale të Komunës, nenit 32 të Statutit të Komunës së Hani Elezit, 01 Nr. 2487 datë 24.12.2014, Kuvendi i Komunës së Hani Elezit, në mbledhjen e mbajtur më datë 16.07.2018 merr:

VENDIM

PËR FILLIMIN E HARTIMIT TË HARTËS ZONALE TË KOMUNËS

I

Lloji i dokumentit të planifikimit hapësinor

Kuvendi i Komunës miratoi vendimin për fillimin e procesit të hartimit të Hartës Zonale të Komunës së Hani Elezit, "në tekstin e mëtejshëm: HZK".

II

Përkufizimi i dokumentit të planifikimit hapësinor

Harta Zonale e Komunës (HZK) është një dokument multi-sektorial që përmes grafikëve, fotografive, hartave dhe tekstit përcakton hollësisht llojin, shfrytëzimin e planifikuar të hapësirës dhe masat e veprimit të cilat bazohen në kohëzgjatje dhe projeksione të arritshme të investimeve publike dhe private për tërë territorin e Komunës, për një periudhë tetë (8) vjeçare.

III

Qëllimi i hartimit

Me HZK nga neni 1. i këtij vendimi, do të përcaktohen kushtet zhvillimore dhe kushtet ndërtimore për zonat urbane dhe rurale në kontekst të ndryshimeve të bëra dhe harmonizimin e tyre me nevojat reale dhe mundësitë për të arritur kushte optimale të rregullimit dhe ndërtimit në Komunën e Hanit të Elezit, plotëson kërkesat ligjore për rregullimin e zhvillimeve në zonën urbane dhe rurale.

IV

Kufiri i territorit

HZK do të mbulojë tërë territorin e komunës, sipërfaqja e të cilit është 8315.7058 ha. Kufiri i territorit për të cilin hartohet HZK nënkupton kufijtë administrativ të zonave kadastrale që e përbëjnë territorin e Komunës së Hanit të Elezit si më poshtë:

1- Tabela e zonave kadastrale

Zona Kadastrale	Kodi i Z.K.	Sipërfaqja m ²	Sipërfaqja ha
Hani i Elezit	73317036	1162277	116.2277
Dimcë	73317025	2120222	212.0222
Dërmjak	73317034	6152071	615.2071
Gorancë	73317019	20801160	2080.116
Krivenik	73317055	12279970	1227.997
Neçavac	73317063	4377620	437.762
Paldenicë	73317066	4046055	404.6055
Pustenik	73317070	10872900	1087.29
Rezhancë	73317073	8508690	850.869
Seçishtë	73317079	8449990	844.999
Vërtomicë	73317015	4386103	438.6103

V

Subjekti përgjegjës për hartim

Bartës i hartimit dhe menaxhimit të procesit për hartimin e HZK është Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit pranë Komunës së Hani Elezit.

VI

Mjetet dhe mekanizmat e nevojshëm për hartim

Mjetet për hartimin e HZK dokumentit të planifikimit hapësinor sigurohen nga buxheti i Komunës së Hanit të Elezit. Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit koordinon procesin e hartimit dhe miratimit të HZK-së në bashkëpunim me drejtoritë sektoriale dhe burimet njerëzore për brenda Komunës. Për shkak të mungesës së kapaciteteve njerëzore, përmes kontratës mbi vepër, Komuna e Hani Elezit, do të angazhojë bashkëpunëtor profesional për të mbështetur procesin e hartimit të HZK- së.

VII

Afati i hartimit

Bartësi i hartimit të HZK (sipas nenit 5 të këtij vendimi), procesin e hartimit dhe miratimit të HZK-së do ta përfundojë në afat prej 36 muaj nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

VIII

Konsultimet publike

Propozim- HZK-ja para finalizimit do të vihet në shqyrtim publik. Shpallja e Propozim- HZK-s në shqyrtim publik dhe koha për dhënien e shqyrtimeve dhe komenteve do të shpallen përmes njoftimeve publike.

IX

Afati i vlefshmërisë

HZK hartohet për periudhë kohore 8 (tetë) vjeçare.

X

Gjuha Zyrtare

HZK sipas nenit 1 të këtij vendimi duhet të jetë në gjuhët zyrtare të Komunës dhe së paku në 3 (kopje) të shtypura e të vulosura dhe 3 kopje digjitale të origjinalit.

XI

Programi

Pjesë e këtij vendimi është edhe programi për hartimin dhe menaxhimin e procesit të planifikimit të HZK-së së Hanit të Elezit, i paraparë me nenin ll., paragrafi 1.3 të Ligjit për Planifikimin Hapësinor Nr. 04/L-174. Procesi i hartimit të HZK-së do të zhvillohet sipas programit ku janë përcaktuar fillimi, përfundimi dhe kohëzgjatja e parashikuar e secilës fazë dhe për secilën fazë janë përcaktuar aktivitetet, produktet dhe rezultatet e pritura.

XII

Hyrja në fuqi

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës – MAPL, si dhe pas publikimit në webfaqen zyrtare të komunës.

XIII

Me këtë vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, dhe Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data: 16.07.2018

